



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

Legjislacioni IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 59

Prishtinë, më 26 qershor 2013, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

**P r o c e s v e r b a l**

**I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme**

**Në mbledhje morën pjesë:** Albin Kurti, Enis Kervan, Sabri Hamiti, Emilija Rexhepi dhe Petar Miletqi.

**Munguan:** Hydajet Hyseni, Berat Buzhala, Skender Hyseni dhe Donika Kadaj-Bujupi.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Zylfije Prapashtica, Adelina Buzhala-Oda Ekonomike Franko-Kosovare, Driton Selmanaj, Besnik Ramadanaj-KDI, Vlora Nushi-SRSG, Arta Lokaj-Drejtorja për Protokoll, Lumnije Murati -ZPRK, Yll Buleshkaj – OSBE, Floriana Shala- OSBE dhe Shefki Kastrati – NDI.

**Nga Zyra e Komisionit:** Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe praktikantet: Gurjeta Zeka dhe Tringa Bytyqi.

**Mbledhjen e kryesoi,** Albin Kurti, Kryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

**R e n d d i t e:**

1. Dëgjim i ish-ambasadorit të Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Suedisë dhe ish-shefit të Misionit të Posaçëm të Republikës së Kosovës në Beograd, z. Lulzim Peci.

**1. Dëgjim i ish-ambasadorit të Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Suedisë dhe ish-shefit të Misionit të Posaçëm të Republikës së Kosovës në Beograd, z. Lulzim Peci**

**Albin Kurti** – Duke falënderuar z. Lulzim Peci për gatishmërinë e tij për të raportuar në Komision, theksoi se Komisioni ka qenë gjithmonë i interesuar për rrjedhat e dialogut politik në Bruksel të zhvilluara ndërmjet Kryeministrit të Kosovës, Thaçi dhe atij të Serbisë Daçiq. Vuri në pah se, Kryeministri nuk i është përgjigjur ftesës që të vijë të raportojë në Komision. Ndërsa ministri i Punëve të Jashtme, z. Enver Hoxhaj, tha se ka qenë një herë vitin e kaluar dhe vetëm një herë këtë vit për të raportuar në Komision. Informoi se ministri është ftuar edhe më 23 maj të këtij viti, ftesës i është përgjigjur pozitivisht të premtën e kaluar dhe e ka anuluar ardhjen këtë të hënë. Theksoi se qëllimi i Komisionit ka qenë që ta dëgjojë ministrin për dy gjëra kryesore: dialogun politik në Bruksel dhe Marrëveshjen për Normalizim e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe

Republikës së Serbisë, si dhe për çështjen e dorëheqjes së z. Lulzim Peci. U shpreh i vetëdijshëm që Komisioni do të duhej që paraprakisht ta kishte raportin e Kryeministrit dhe të ministrit të Jashtëm dhe pastaj ta mbante këtë dëgjim. Mirëpo, në pamundësinë e kësaj dhe duke qenë shumë të shqetësuar për politikën e jashtme të Republikës së Kosovës në gjendjen në të cilën ndodhet aktualisht, tha se është ftuar ky dëgjim.

**Lulzim Peci** - Shprehu nderin dhe privilegjin që të dëshmojë sipas ftesës së Komisionit, si ish - ambasador në Mbretërinë e Suedisë, dhe si ish-shef i Misionit të Posaçëm në Beograd. Lidhur me performancën e tij, ai tha se ka marrë vetëm lëvdata dhe asnjë kritikë. Përpos detyrave si ambasador, tha se ka ndihmuar grupet punuese të MPJ-së në draftimin e Strategjisë së Lobimit, dokumenteve kyçe të politikës së jashtme dhe sigurisë, si dhe Draft- Propozimin për Zyrën Ndërlidhëse në Beograd. Gjithashtu, ka qenë anëtar i ekipit për negocimin e aranzhmaneve ndërlidhëse bazuar në marrëveshjen e 4 dhjetorit 2012 ndërmjet Kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi dhe Kryeministrit të Serbisë, z. Ivica Daçiç për këmbimin e zyrtarëve ndërlidhës në mes Prishtinës dhe Beogradit. Bëri të ditur se posti në Beograd nuk ka qenë dëshirë e tij, por kërkesë e MPJ-së të cilës iu është përgjigjur me përkushtim. Informoi se më 13 qershor 2013, ka dorëzuar detyrën e tij si Ambasador dhe ka marrë detyrën e Shefit të Misionit të Posaçëm Ndërlidhës në Beograd, për të cilën është dekretuar një ditë më vonë nga Presidentja znj. Atifete Jahjaga. Sa i përket fillimit të punës në Beograd, tha se ka pasur fare pak ndihmë nga MPJ. Ai falënderoi Presidenten Jahjaga, e cila tha se ia kishte dhënë një pjesëtarë të njësisë për mbrojtje të afërt të Policisë së Kosovës për ta vozitur dhe përkujdesur gjatë qëndrimit njëditor në Beograd. Informoi se është nisur për në Beograd më 17 qershor 2013. Atje pas takimit me Shefin e Delegacionit të BE-së, z. Vincent Degert, iu është drejtuar gazetarëve të mbledhur para zyrrave të Delegacionit të BE-së të cilët i ka përshëndetur në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Deklaratën, “Kjo është ditë e rëndësishme për normalizimin e marrëdhënieve në mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, shpresoj se do të kemi marrëdhënie të hapura dhe korrekte me institucionet shtetërore të Serbisë, dhe jam këtu për të dhënë kontributin tim në normalizimin e marrëdhënieve në mes dy shteteve tona” tha se e ka dhënë në gjuhën serbe. Pasi që është kthyer në Prishtinë, po të njëjtën ditë, informoi se, në një restorant, rastësisht, është takuar me Kryeministrin Thaçi, i cili e ka kritikuar ashpër se pse ka deklaruar në media që normalizimi i plotë i marrëdhënieve në mes Kosovës dhe Serbisë nënkupton njohjen e vendit tonë nga kjo e fundit dhe e ka sugjeruar që për këto gjëra të këshillohet me Ministrin Hoxhaj. Informoi se ditën e nesërme ka vendosur që të jap dorëheqje të parevokueshme nga Shërbimi Diplomatik i Republikës së Kosovës. Sa i përket komunikatës së MPJ-së, tha se, ajo e ka dëmtuar rëndë imazhin e politikës së jashtme dhe të Shërbimit Diplomatik të Kosovës. Gjithashtu, tha se nuk është personi i parë në Kosovë, ndaj të cilit bëhen përpjekje të tilla për denigrim të personalitetit dhe punës, por shpreson të jetë i fundit.

**Albin Kurti** – Duke iu referuar komunikatës së 15 qershorit të MPJ-së ku thuhet se Presidentja Jahjaga “priti ambasadorin e Republikës së Kosovës, z. Lulzim Peci, i cili me dekret të veçantë është emëruar Shef i Misionit të Posaçëm të Kosovës në Beograd” dhe komunikatës së 19 qershorit, ku MPJ thotë se z. Peci është “emëruar zyrtar ndërlidhës në Beograd si përfaqësues i Republikës së Kosovës me propozim të MPJ-së dhe Kryeministrit Thaçi”, i shtroi këto pyetje: A mund të na tregoni cili ka qenë pozicioni juaj ligjor në Beograd? Kush ju ka propozuar për këtë pozicion? Kur e keni pranuar zyrtarisht këtë pozicion? A e keni dhe a mund ta dorëzoni dokumentin e dekretimit tuaj nga Presidentja? Më tej, z. Kurti duke iu referuar komunikatës së MPJ-së të 19 qershorit ku thuhet “I kemi kuptuar lëshimet e tij për disa vite si ish-ambasador në Suedi...”, shtroi këto pyetje: Gjatë shërbimit tuaj në misionin diplomatik në Suedi sa takime i keni pasur me ministrin Enver Hoxhaj? A keni pranuar ndonjë vërejtje me shkrim nga ministri për punën tuaj? Nëse po, a mund të

na prezantoni dokumentin? A keni pranuar ndonjë vërejtje me gojë nga ministri Hoxhaj? A keni pranuar çfarëdo vërejtje nga ndonjë zëvendësministër, apo zyrtar tjetër në MPJ? A mund të na prezantoni formularin e vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm nëse e keni? Më tutje, duke iu referuar po asaj komunikate, ku thuhet që “z. Peci ka qenë i propozuar për shkarkim dhe këtë ai e ka pasur të qartë, andaj edhe dorëheqja është hap i paraparë i tij”, z. Kurti shtroi këto pyetje: A ju është prezantuar një propozim për shkarkim para se ju ta ofroni dorëheqjen? Nëse po, a mund të na prezantoni vendimin e Komisionit disiplinor për shkarkim? Kë keni njoftuar për dorëheqjen tuaj? Në cilën datë e keni dorëzuar atë? A keni pranuar përgjigje pas dorëheqjes? Gjithashtu, pyeti, pse e keni bërë dorëheqjen publike dhe pse të parevokueshme? Pse nuk e keni ruajtur diskrecionin? A jeni befasuar pse Kryeministri ju kritikoi, apo për shkak të përmbajtjes së kritikës? A e keni konsideruar Kryeministrin të jetë tjetër karakter e me qëndrime të tjera prej atyre siç ju shfaq tash së fundi? A konsideroni që e keni njohur mirë Kryeministrin gjatë viteve të shkuara para këtij takimi të fundit me të? A keni pranuar një listë me shkrim të qëndrimeve që duhet mbajtur në Beograd? Nëse po, nga kush e keni pranuar atë listë? A mund të na dorëzoni një dokument të tillë? Nëse jo, a u janë prezantuar me gojë qëndrimet që duhet mbajtur në Beograd? Nëse po, a mund të na i citoni ato? Duke iu referuar deklaratës së z. Peci në Beograd se “Normalizimi i raporteve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë do të ndodhte vetëm atëherë kur kjo e fundit ta njohë pavarësinë e Kosovës”, z. Kurti tha se pikërisht pas kësaj deklarate ka ardhur dorëheqja juaj. A ka qenë kjo deklaratë në shpërputhje me qëndrimet shtetërore? Çfarë kritika keni pranuar pas kësaj deklarate? Nga kush? A mund t’i citoni ose, së paku, t’i prezantoni fjalitë e kritikës? Ku ndodhi ky takim, kur, si dhe kush ishte gjithsej i pranishëm aty? Gjatë shërbimit tuaj në misionet diplomatike sa herë jeni takuar me Kryeministrin Thaçi? A keni pranuar ndonjë vërejtje me shkrim apo me gojë nga Kryeministri Thaçi? Nëse po, a mund të na prezantoni dokumentet përkatëse ose citoni vërejtjet? A keni pranuar formularë vlerësimi nga Kryeministri Thaçi? Nëse po, ju lutemi na dorëzoni dokumentin. Duke iu referuar komunikatës së MPJ-së ku thuhet që z. Peci ka pasur takime të paautorizuara me përfaqësues të shtetit të Serbisë, z. Kurti shtroi këto pyetje: Me cilën datë keni qenë në Beograd si përfaqësues i Kosovës? A mund të na tregoni nga kush keni qenë të shoqëruar gjatë vizitës tuaj në Beograd? Sa takime keni pasur dhe me kë jeni takuar atje? A jeni takuar me ministrin ose Kryeministrin pas vizitës tuaj në Beograd? Te kush keni raportuar për këtë vizitë dhe për takimet atje?

**Lulzim Peci** - Duke iu përgjigjur pyetjeve të cilat i shtroi kryetari i Komisionit, tha se me dekretin e Presidentes është emëruar Shef i Misionit të Posaçëm Ndërlidhës të Republikës së Kosovës në Beograd. Sa i përket pozicionit ligjor, tha se për Republikën e Kosovës është Shef i Misionit të Posaçëm Ndërlidhës, për Brukselin është Zyrtar Ndërlidhës i Kosovës/Prishtinës në Beograd, ndërsa për Beogradin është Zyrtar Ndërlidhës i Prishtinës në Beograd. Tha se më herët ka qenë i udhëzuar nga ministri i MPJ-së, që të merret me çështjet e integritetit të Kosovës në NATO, mirëpo, pas vitit të ri, është kontaktuar nga ministri Hoxhaj i cili i ka kërkuar që ta udhëheqë këtë mision. U shpreh se kjo nuk ka qenë dëshirë e tij aspak. Thëksoi se kurrë nuk ka pranuar vërejtje me shkrim apo me gojë nga ministri, por ka pasur vetëm lëvdata. Njoftoi se formularët e vlerësimit janë vetëm për stafin në pozita më të ulëta se të ambasadorëve. Bëri të ditur, se nuk ka pasur kurrfarë njohurie që ka qenë i propozuar për shkarkim. Dorëheqjen tha se e ka bërë më 19 qershor dhe fillimisht e ka njoftuar Presidenten Jahjaga përmes telefonit dhe pastaj edhe me e-mail. Njoftoi se është ndier i befasuar nga kritikën e Kryeministrit dhe se në atë moment nuk e ka pasur të qartë se në çfarë terreni politik është duke punuar. Ai deklaroi se nuk ka pranuar kurrfarë liste me shkrim të qëndrimeve që duhet mbajtur në Beograd, e as me gojë nuk i janë prezantuar ato. Informoi se deklaratën, “Normalizimi i raporteve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë do të ndodhte vetëm atëherë kur kjo e fundit ta njohë pavarësinë e Kosovës” e ka dhënë në “Klan

Kosova”, e jo në Beograd. Njoftoi se nuk ka mbajtur asnjë takim të paaautorizuar me përfaqësues të shtetit të Serbisë dhe gjatë gjithë kohës ka qenë në përcjellje nga pjesëtari i njësisë për mbrojtje të afërt të Policisë së Republikës së Kosovës, ndërsa në media ka dalë me autorizim të Kryeministrit Thaçi.

**Sabri Hamiti** – Theksoi se i ka perceptimet e tij për punën e secilit ambasador të Republikës së Kosovës, ndërsa sa i përket referimit të z. Pecit, për mungesën e vlerësimeve zyrtare të punës së ambasadorëve, njoftoi se në takimet e Komisionit me ministrin Hoxhaj, ai i ka kërkuar ministrit vlerësimet zyrtare për ambasadorë. Shprehu shqetësimin e tij lidhur me konfuzionin e krijuar në publik, rreth titullit ambasador dhe rreth misionit në të cilin ka qenë i ngarkuar, z. Peci.

Z. Hamiti tha se dyshon në rastësinë e takimit të z. Peci me Kryeministrin dhe ministrat e tjerë dhe bisedën për një problem të tillë në kafene. Kjo situatë e krijuar, sipas tij i bën dëm diplomacisë kosovare. Shërbimi diplomatik i Republikës së Kosovës në gjendjen e tanishme politike dhe ekonomike, duhet të jetë shumë i kujdesshëm dhe nuk duhet të lejojë që të ndodhin moskuptime të tilla. Ai theksoi se komunikimi publik për këtë çështje është bërë në mënyrë jo të duhur dhe ka krijuar një situatë kaotike.

**Petar Miletij** – Theksoi se Komisioni ka për detyrë dhe obligim që të mbikëqyrë punën e MPJ-së, prandaj edhe është ftuar z. Peci, që të sqaroj se a janë respektuar të gjitha procedurat lidhur me dorëheqjen e tij. Diskutimin e z. Peci në gjuhën serbe, nuk e konsideron se do të duhej të ishte ndër vërejtjet kryesore, në deklaratën e MPJ-së, me rastin e kësaj dorëheqjeje, ngase theksoi se gjuha serbe është njëra nga dy gjuhët zyrtare në Kosovë. Ky fakt tha se do të mund të ndikojë edhe në pasardhësin e z. Peci, që të mos veprojë në të njëjtën mënyrë. Theksoi se nuk është mirë që takimet jashtë institucioneve të sjellin deri te kjo gjendje serioze, megjithatë ky është vendim i Qeverisë, dhe si të tillë do ta respektojë.

**Emilija Rexhepi** - Në diskutimin e saj pyeti z. Peci se, a mendon se e ka dëmtuar pasqyrën diplomatike të vendit tonë me dorëheqjen e tij vetëm dy ditë pas emërimit në pozitën e zyrtarit ndërlidhës, në momentin e nismës së marrëdhënieve diplomatike me rëndësi historike, si për Kosovën ashtu edhe për Serbinë.

**Enis Kervan** - Falënderoi z. Peci për sqarimet e dhëna dhe shtoi se kishte qenë më mirë që ai të vinte në cilësi të ambasadorit për të informuar në Komision dhe jo tani pasi kanë ndodhur këto moskuptime. Theksoi se Komisioni është i detyruar ta mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për Shërbimin Diplomatik dhe kërkoi që MPJ, të ofrojë informata zyrtare lidhur me këtë çështje.

**Albin Kurti** - Tha se një konkluzion i rëndësishëm është ai që e përmendi z. Peci, se nga pikëpamja e Republikës së Kosovës ai ishte Shef i Misionit të Posaçëm Ndërlidhës, kurse nga pikëpamja e Bashkimit Evropian dhe Republikës së Serbisë ishte Zyrtar Ndërlidhës i Prishtinës në Beograd. Ngriti shqetësimin për bazën ligjore të këtij misioni, sepse në Ligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës nuk parashihen Misione të Posaçme Ndërlidhëse, por vetëm Misione të Posaçme, duke shtruar pyetjen se mos është tejkaluar baza ligjore dhe se a i referohet marrëveshjes, e cila nuk ka qenë pjesë e legjislacionit të Kosovës ende. Konstatimin e z. Pecit se ai në komunikim me MPJ-në, pas shërbimit në Mbretërinë e Suedisë të përgatitet për diplomacinë në fushën e integritetit të Kosovës në NATO dhe caktimin e tij në mënyrë ad-hoc në pozitën e Shefit të Misionit të Posaçëm Ndërlidhës në Republikën e Serbisë, e konsideroi një kontrast të madh dhe një kalim të shpejtë të detyrës për të qenë i përgatitur. Po ashtu tha se është i vlefshëm konstatimi i z. Peci se, asnjëherë nuk ka marrë ndonjë vërejtje me shkrim dhe me gojë, as nga ministri, as nga ndonjë zyrtar tjetër i ministrisë, gjatë ushtrimit të detyrës së tij. Duke iu referuar fjalimit të z. Pecit, z. Kurti,

kërkoi të njoftohet më shumë rreth mënyrës së dorëheqjes së tij, dhe se a është dorëzuar ndonjë njoftim zyrtar në MPJ para se të bëhej publike dorëheqja. Ai shprehu mendimin se dorëheqja e z. Pecit vjen nga qëndrimi, reagimi dhe kritikë të ashpra të Kryeministrit. Ai, po ashtu kërkoi të dijë se si kanë reaguar ministrat e tjerë, që ishin të pranishëm me Kryeministrin.

**Lulzim Peci** - Duke iu referuar diskutimit të deputetit Hamiti tha se takimi me Kryeministrin dhe ministrat e tjerë ka qenë plotësisht i rastësishëm dhe sikur të mos kishte ndodhur ky takim i rastësishëm, ai do ishte në Beograd dhe do ta vazhdonte punën pa asnjë problem. Z. Peci tha se dorëheqjen e tij, ia ka dorëzuar vetëm Presidentes Jahjaga dhe jo MPJ-së. Duke iu referuar pyetjes së deputetes znj. Rexhepi tha se nuk është në gjendje të vlerësojë se a është dëmtuar imazhi i politikës së jashtme të Kosovës, mirëpo shprehu mendimin se reagimi i MPJ-së i ka shkaktuar dëme imazhit të politikës së jashtme të Kosovës.

**Albin Kurti** - Kërkoi të dijë nëse z. Peci, ja ka dorëzuar Presidentes Jahjaga dorëheqjen e tij me shkrim para se ta publikojë në media dhe e përsëriti pyetjen se si kanë reaguar ministrat e tjerë të pranishëm me Kryeministrin Thaqi. Shfaqti përshtypjen e tij, se dorëheqja e z. Peci nuk ka ardhur për shkak të kritikave të Kryeministrit, por për shkak të ndonjë ofendimi.

**Enis Kervan** - Ngriti shqetësimin se çështjet private e bisedat joformale nuk duhet të jenë çështje të shqyrtimit në Komision. Diskutimin e z. Peci lidhur me dëmtimin e imazhit të diplomacisë kosovare me situatën e krijuar, e konsideroi kundërthënëse.

**Lulzim Peci** - Tha se dorëheqjen e tij ia ka dorëzuar Presidentes Jahjaga përmes postës elektronike, para se atë ta dorëzojë në media. Në pyetjen e kryetarit të Komisionit për reagimin e ministrave tjerë, z. Peci bëri të ditur se ata kanë qenë të heshtur, përveç ministrit Hoxhaj i cili ka thënë se është kuptuar me z. Peci, që ai nuk duhet të dalë në media.

Takimi përfundoi në orën 11:30

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti